

VENDIM
Nr. 649, datë 8.10.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË NJË PJESE TË PRONËS NR. 17/16, ME EMËRTIMIN “ISH-
DREJTORIA E DOĞANËS DURRËS”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 586, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME
DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR”**

(Ndryshuar me VKM nr. 302, datë 21.5.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të katit të dytë të pronës së paluajtshme me nr. 17/16, me emërtimin “Ish-Drejtoria e Doganës Durrës”, me sipërfaqe ndërtimi 538,63 (pesëqind e tridhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e tre) m², mbi sipërfaqe trualli 602,21 (gjashtëqind e dy presje njëzet e një) m² në Durrës, ZK 8514, për përdorim nga Zyra Rajonale e Përmbarimit Durrës, *Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Durrës, sipas planimetrisë bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.*


2. Kati i dytë i pasurisë së paluajtshme, të përmendur në pikën 1, hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”.

3. Ndalohen tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




RESTAURIM KYRA TE GJYKATES ADMINISTRATIVE DURRES	PLANIMETRIA E KATIT ambjentet qe restauron	EV STUDIO	GJYKATA ADMINISTRATIVE DURRES	PROJEKT RESTAURIM DHE INTERIER	SHKURTOR 2013 1:24
---	---	-----------	----------------------------------	-----------------------------------	-----------------------

PLANIMETRIA EKZISTUJESSE

KATI II

5m x 10m



mi "Gjodine 2 KJ" Durrës
 Sheshi e Zyrtar e Permbanimit

MIRATOHEJ
 R.R.T. e BASHKISE DURRES
 KRYETARI
 after KOKA

TARI K.R.T. e BASHKISE DURRES
 der CILIKUPA

